



PEOPLE IN FOCUS

2025

CHILD PROTECTION POLICY



PEOPLE in
FOCUS

 People in Focus Albania

 peopleinfocus.org

Tirana, Albania

POLITIKAT E MBROJTJES SË FËMIJËVE “People in Focus”

**PRILL, 2025
TIRANË**



Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje
 2. Qëllimi dhe Parimet e Politikës
 3. Përkufizime dhe Terma
 4. Kodi i Sjelljes
 5. Anëtarët e Stafit
 6. Oficeri i Mbrojtjes Së Fëmijëve
 7. Vlerësimi dhe Zbutja e Rrezikut
 8. Raportimi
 9. Llogaridhënia
 10. Konfidencialiteti
 11. Kontakte referimi jashtë organizatës
 12. Kontakte
- Aneks

1. Hyrje

Mbrojtja e fëmijëve është një shqetësim universal, që prek fëmijët dhe të rinjtë në çdo shoqëri dhe shtet.

Abuzimi mund të marrë forma të shumta—fizike, seksuale, emocionale ose përmes neglizhencës—dhe mund të ndodhë në çdo mjedis ku është i pranishëm një fëmijë ose të rinj.

Tek *People in Focus (PIF)*, ne jemi të përkushtuar për të parandaluar abuzimin, për të raportuar shqetësimet dhe për të mbështetur fëmijët e prekur. Për të udhëhequr punën tonë, ne kemi zhvilluar një Politikë gjithëpërfshirëse për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Organizata PIF u themelua në vitin 2014 nga një grup njerëzish aktivë si një organizatë sociale humanitare, jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse. Qëllimi i saj është të mbështesë dhe përfaqësojë komunitetet në zhvillim në çështjet e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe progresit shoqëror, duke synuar të ketë ndikim të qëndrueshëm në komunitet.

Organizata është thellësisht e angazhuar në procesin e gjatë dhe të vazhdueshëm në përmirësimin e çështjeve problematike dhe fuqizimin e qytetarëve sipas standardeve të mirë-përcaktuara. Puna jonë përqendrohet në vlerësimin dhe monitorimin e kushteve sociale të grupeve të ndryshme vulnerabël, të ndjekura nga analiza dhe studime për të dhënë një pasqyrë dhe të kuptuar të situatës. Ne kemi përvojë të gjerë në bashkëpunimin me institucionet publike për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike.

Me një bazë solide në edukimin joformal, PIF është një organizatë dinamike e specializuar në angazhimin social dhe ndërkulturor. Ne ofrojmë aktivitete për rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve, workshpeve, shkëmbimeve rinore dhe fushatave ndërgjegjëse, duke adresuar një gamë të gjerë të nevojave të komunitetit.

PIF gjithashtu menaxhon programe të financuara nga BE-ja, duke përfshirë Horizon Europe, Erasmus+, Interreg dhe Creative Europe, dhe bashkëpunon në mënyrë efektive me autoritetet lokale dhe komunitetet për të zbatuar projekte me ndikim.

PIF e konsideron thelbësore krijimin e një hapësire të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë, ku ata mund të ndajnë lirisht mendimet e tyre dhe të angazhohen hapur me të tjerët.

Ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të mbështetur zhvillimin e tyre dhe për të garantuar sigurinë e tyre.

2. Qëllimet dhe Parimet e Politikës

Kjo politikë është hartuar për të siguruar që të gjithë fëmijët e përfshirë në aktivitetet e PIF të jenë të sigurt dhe të mbrojtur, pavarësisht se kush janë ose nga vijnë.

Ajo zbatohet për të gjithë —pavarësisht moshës, aftësisë, racës, fesë, identitetit gjinor ose orientimit seksual—dhe synon të parandalojë çdo formë dëmtimi, abuzimi, neglizhence ose keqtrajtimi.

Kjo politikë përshkruan se si të parandalohet çdo rrezik përmes komunikimit të hapur, edukimit dhe raportimit kur diçka duket e gabuar. Qëllimi ynë është të krijojmë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për çdo fëmijë që krijojmë kontakt dhe me të cilin punojmë.

Gjatë krijimit të kësaj politike, PIF e ka bazuar atë në idetë dhe vlerat kryesore që gjenden në marrëveshjet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut dhe në Kushtetutën e Shqipërisë.

Bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës

Kjo Politikë e Mbrojtjes së Fëmijëve trajton mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, sipas përkufizimit të dhënë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.

Konventa duhet të interpretohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke ofruar një kuadër të plotë për mbrojtjen, përkujdesjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e PIF kanë të drejtën që mirëqenia dhe interesi i tyre më i lartë të jenë gjithmonë prioritet absolut.

Ligji Nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.¹

Ky ligj, i miratuar në vitin 2017, vendos një kuadër të plotë për garantimin e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve në të gjithë vendin.

Ligji parashikon krijimin e strukturave të posaçme, si Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të cilat kanë për detyrë mbikëqyrjen dhe koordinimin e përpjekjeve për mbrojtjen e fëmijëve.

ANGAZHIMI DHE PARIMET TONA

- Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për mbrojtje nga abuzimi dhe shfrytëzimi.

¹ https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/04_Ligj_18_2017_23.02.2017_Per_te_drejtat_dhe_mbrojtjen_e_femijes.pdf



- Ne do të punojmë për përmirësimin e jetës së të gjithë fëmijëve, duke mbështetur dhe mbrojtur të drejtat e tyre, ashtu siç përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.
- Tolerancë zero ndaj abuzimit të fëmijëve.
- Jemi të përkushtuar të mbrojmë fëmijët me të cilët dhe për të cilët punojmë.
- Të dëgjojmë me vëmendje mendimet e fëmijëve dhe të veprojmë gjithmonë në përputhje me parimin e “interetit më të lartë të fëmijës”.

Dinjiteti: Dinjiteti i fëmijës duhet të respektohet në çdo kohë. Gjuha e përdorur nuk duhet të jetë degraduese, viktimizuese apo poshtëruese për fëmijën. Në imazhe, fëmijët duhet të paraqiten gjithmonë të veshur në mënyrë të përshtatshme dhe kurrë në poza që mund të interpretohen si provokuese seksualisht.

Korrektësia: Përfaqësimi i fëmijëve në komunikime nuk duhet të manipulohet apo të ekzagjerohet në asnjë mënyrë. Imazhet dhe historitë duhet të ofrojnë një pasqyrë të balancuar të jetës dhe rrethanave të fëmijës, duke balancuar aspektet negative me imazhe fuqizuese ose duke treguar progresin që ata arrijnë. Duhet shmangur çdo përgjithësim që nuk pasqyron realitetin dhe imazhet nuk duhet të merren apo të përdoren jashtë kontekstit.

Privatësia: Çdo informacion që mund të përdoret për të identifikuar një fëmijë ose që mund ta vendosë atë në rrezik nuk do të përdoret.

Kjo politikë gjithashtu shërben si udhëzues për stafin tonë, punonjësit me të rinjtë, ekspertët, vullnetarët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm me të cilët punojmë. Ajo shpjegon rregullat dhe përgjegjësitë kryesore që ndjekim për të mbrojtur fëmijët.

3. Përkufizime dhe Terma

Fëmijë: Sipas nenit 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (CRC) dhe nenit 3 të Ligjit Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" në Shqipëri, një "fëmijë" është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.

Mbrojtja e Fëmijës: Mbrojtja e fëmijës i referohet parandalimit dhe reagimit ndaj abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve. Ajo përfshin masa të ndërmarra për të siguruar, mirëqenien, sigurinë dhe të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë si veprime parandaluese, ashtu edhe reaguese.



Abuzimi ndaj Fëmijëve: Abuzimi ndaj fëmijëve i referohet çdo akti, sjelljeje ose mosveprimi që dëmton mirëqenien fizike, emocionale ose psikologjike të një fëmije. Ai mund të përfshijë abuzim fizik, abuzim seksual, abuzim emocional, neglizhencë ose shfrytëzim.

Abuzimi Fizik: Abuzimi fizik nënkupton çdo akt të qëllimshëm dhune fizike ose dëmtimi ndaj një fëmije ose personi të cenueshëm. Ai përfshin përdorimin e forcës fizike që mund të shkaktojë dhimbje, dëmtim, paaftësi ose shqetësim. Abuzimi fizik mund të manifestohet në forma të ndryshme, si goditje, grushtime, shkelmim, djegie, tundje ose çdo veprim tjetër që shkakton dëmtim fizik.

Abuzimi Seksual: Abuzimi seksual përfshin çdo formë aktiviteti ose sjelljeje seksuale të imponuar mbi një fëmijë ose individ të cenueshëm pa pëlqimin ose pa mirëkuptimin e tyre. Ai përfshin një gamë të gjerë veprimesh, si përdhunim, ngacmim seksual, incest, ekspozim ndaj materialeve eksplicite ose çdo sjellje tjetër shfrytëzuese në aspektin seksual. Mund të përfshijë gjithashtu veprime pa kontakt fizik, si përfshirja e fëmijëve në shikimin ose prodhimin e materialeve pornografike, apo nxitja e tyre për sjellje seksuale të papërshtatshme.

Abuzimi Emocional: Abuzimi emocional i referohet një modeli sjelljeje që synon të minojë, manipulojë, kontrollojë ose poshtërojë mirëqenien emocionale dhe vetëvlerësimin e një fëmije ose individi të cenueshëm. Ai përfshin përdorimin e metodave verbale ose joverbale për të shkaktuar shqetësim emocional, si kritika të vazhdueshme, poshtërime, fyerje, kërcënime, intimidim ose izolim.

Neglizhenca ndaj Fëmijëve: Neglizhenca nënkupton dështimin për të plotësuar nevojat bazë të një fëmije, duke përfshirë ushqimin, strehimin, veshjen, arsimin dhe kujdesin shëndetësor. Ajo paraqet një model të mungesës së kujdesit ose vëmendjes ndaj mirëqenies së fëmijës, i cili mund të çojë në dëmtim fizik, emocional ose zhvillimor.

Shfrytëzimi i Fëmijëve: Shfrytëzimi i fëmijëve përfshin përdorimin, abuzimin ose shfrytëzimin e fëmijës për qëllime personale ose komerciale. Kjo përfshin punën e fëmijëve, trafikimin e fëmijëve, shfrytëzimin seksual të fëmijëve, martesat e hershme si dhe çdo formë tjetër praktike të dëmshme apo shfrytëzuese.

Bullizmi: Një sjellje agresive e përsëritur dhe e qëllimshme, që përfshin një pabarazi pushteti, ku një individ ose një grup individësh synon të dëmtojë, shqetësojë ose frikësojë një person tjetër. Ngacmimi mund të marrë forma të ndryshme, si fizik, verbal, marrëdhënor ose përmes internetit (cyberbullying).

4. Kodi i sjelljes

PIF është e angazhuar të bëjë gjithçka që është e mundur për të parandaluar dhe trajtuar situatat ku fëmijët mund të jenë në rrezik.

Ne do të marrim seriozisht çdo raportim të abuzimit dhe veprimet tona do të jenë gjithmonë në përputhje me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Çdo shqetësim do të raportohet menjëherë pranë shërbimeve përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve ose autoriteteve të policisë.

Ky Kod Sjelljeje përfshin udhëzime mbi standardet etike dhe të përshtatshme të sjelljes së të rriturve ndaj fëmijëve, si dhe të fëmijëve ndaj njëri-tjetrit.

Kodi është hartuar duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe duhet të interpretohet me frymën e transparencës dhe të mirës së përbashkët.

Ne dëshirojmë që të gjithë fëmijët dhe të rriturit e përfshirë në aktivitetet e People in Focus të ndihen të sigurt, të respektuar dhe të lumtur.

ÇFARË DUHET TË BËNI:

- Të njihni çfarë përbën abuzim dhe shfrytëzim të fëmijëve (sipas Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve) dhe të kuptoni dispozitat përkatëse.
- Të njihni shenjat e abuzimit dhe të raportoni çdo vëzhgim të dyshimtë menjëherë tek Oficeri i Mbrojtjes së Fëmijëve.
- Të trajtoni të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë: të jeni gjithëpërfshirës dhe të përfshini të gjithë fëmijët pa diskriminim.
- Të qëndroni vigjilentë ndaj situatave të rrezikshme ndërmjet bashkëmoshatarëve (p.sh. përzjerje e pambikëqyrur e fëmijëve më të mëdhenj me ata më të vegjël dhe mundësitë e diskriminimit).
- Të jeni të kujdesshëm në mënyrën si përdorni gjuhën, veprimet dhe marrëdhëniet me fëmijët.
- Të ndërmerreni masa të veçanta mbrojtjeje për fëmijët më të vegjël dhe veçanërisht për ata vulnerabël nga abuzimi i bashkëmoshatarëve ose i të rriturve.
- Të krijoni një mjedis mundësues për zhvillimin personal, fizik, social, emocional, moral dhe intelektual të fëmijëve.
- Të inkurajoni dhe të respektoni mendimet dhe zërin e fëmijëve.
- Të kufizoni aksesin ose të mos ekspozoni fëmijët ndaj materialeve të papërshtatshme elektronike.
- Të respektoni konfidencialitetin e të dhënave personale të fëmijëve në çdo kohë.
- Të merrni pëlqim të shkruar nga fëmija dhe prindi/kujdestari përpara fotografimit, filmimit ose mbledhjes së të dhënave personale gjatë aktiviteteve.
- Të siguroheni që gjatë takimeve me fëmijët të jenë të pranishëm të paktën dy anëtarë të stafit, për të garantuar mbikëqyrje dhe siguri.

- Të dakordësoni paraprakisht me prindërit/kujdestarët dhe fëmijët ndarjen e dhomave kur aktivitetet përfshijnë qëndrime të natës.

ÇFARË NUK DUHET TË BËNI:

- ❖ Mos diskriminoni, mos turpëroni, mos poshtëroni, mos përulni dhe mos cenoni dinjitetin e fëmijëve. Kjo përfshin çdo veprim që mund të konsiderohet abuzim emocional (p.sh., përdorimi i një gjuhe që dëmton mendërisht ose emocionalisht një fëmijë, tregimi i një historie ose shfaqja e imazheve që mund të shkaktojnë lëndim emocional ose mendor të fëmijës)
- ❖ Mos godisni ose ushtroni dhunë fizike ndaj pjesëmarrësve.
- ❖ Mos veproni në asnjë mënyrë që mund të konsiderohet abuzive ose që mund të rrezikojë të tjerët.
- ❖ Mos toleroni shkeljet e këtij Kodi nga persona të tjerë — staf, vullnetarë, ekspertë, etj.
- ❖ Mos sugjeroni sjellje ose marrëdhënie të papërshtatshme dhe mos inkurajoni ndjenja të tilla nga ana e fëmijëve.
- ❖ Mos fotografoni, filmmoni ose kërkoni të dhëna personale kur kjo nuk është e nevojshme për aktivitetet e PIF.
- ❖ Mos përdorni kontakte personale (përfshirë llogaritë në rrjete sociale) të fëmijëve jashtë aktiviteteve të miratuara nga PIF.
- ❖ Mos qëndroni vetëm me një fëmijë në një ambient privat ose të izoluar — gjithmonë duhet të jetë i pranishëm një i rritur tjetër ose të jetë e mundur mbikëqyrja vizuale.
- ❖ Mos i dhuroni dhurata apo trajtim të veçantë vetëm një fëmijë, pasi kjo mund të krijojë favorizime ose situata të sikletshme.
- ❖ Mos konsumoni alkool, drogë ose mos merrni pjesë në aktivitete me fëmijë duke qenë nën ndikimin e substancave.

5. Anëtarët e Stafit

Kjo Politikë e Mbrojtjes së Fëmijëve zbatohet për të gjithë personat që punojnë ose përfaqësojnë People in Focus — duke përfshirë anëtarët e bordit, stafin, praktikantët, vullnetarët, ekspertët, partnerët dhe palët e treta bashkëpunuese.

Çdo individ njoftohet dhe informohet lidhur me çfarë përbën abuzimi dhe neglizhenca ndaj fëmijëve, mënyrat për t'i parandaluar ato dhe standardet e sjelljes që duhet të ndjekin në punën me fëmijët dhe të rinjtë.

Të gjithë anëtarët e stafit do ta pranojnë dhe do të angazhohen për zbatimin e kësaj Politike të Mbrojtjes së Fëmijëve, duke përmbyllur këto kërkesa:



- a. Stafi, vullnetarët, praktikantët dhe konsulentët/ekspertët rekrutohen në bazë të përshkrimeve të qarta të detyrës ose rolit, të përshtatura me kërkesat e politikës së mbrojtjes së fëmijëve.
- b. Çdo intervistë rekrutimi duhet të përfshijë diskutim mbi çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve, si dhe mbi angazhimin e kandidatit dhe të PIF në këtë drejtim.
- c. Dorëzimi i një certificate të penalitetit (dëshmi penaliteti) që pasqyron çdo dënim penal, përfshirë edhe ato të konsumuarat, është i detyrueshëm për të gjithë kandidatët.

Politika do të ndahet gjithashtu me këto grupe:

- Fëmijët dhe prindërit/kujdestarët e tyre, në mënyrë që të njohin të drejtat e tyre dhe të ndihen të fuqizuar për të mbrojtur veten dhe të tjerët.
- Organizatat partnere, të cilat pritet të respektojnë dhe zbatojnë këtë Politikë, duke mbështetur aktivisht zbatimin e saj.
- Palët e tjera të interesuara, për të promovuar një angazhim më të gjerë në mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

Të gjithë personat e përfshirë në aktivitetet e People in Focus duhet të jenë tërësisht të njohur me këtë Politikë dhe me dispozitat që ajo përmban.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve është e publikuar online dhe mund të lexohet ose shkarkohet nga faqja zyrtare e organizatës: www.peopleinfocus.org.

6. Oficeri për Mbrojtjen e Fëmijëve

PIF është e angazhuar të sigurojë mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, ndaj ka emëruar një Oficer të Mbrojtjes së Fëmijëve të dedikuar, i cili mbikëqyr zbatimin dhe respektimin e politikave dhe procedurave për mbrojtjen e fëmijëve.

Oficerja për Mbrojtjen e Fëmijëve në PIF është znj. Armelia Barci – Drejtore Ekzekutive.

Oficerja për Mbrojtjen e Fëmijëve ka përgjegjësitë kryesore të mëposhtme:

- Udhëheq hartimin, zbatimin dhe rishikimin periodik të politikave dhe procedurave të mbrojtjes së fëmijëve, për të siguruar që ato të jenë gjithmonë të përditësuara dhe efektive.
- Organizon trajnime dhe ëorkshope për të rritur nivelin e njohurive të stafit mbi parimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe zbatimin praktik të tyre në punën e përditshme.
- Krijon dhe mbikëqyr një sistem konfidencial për raportimin e shqetësimeve ose incidenteve që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, duke garantuar që të gjitha rastet të regjistrohen, trajtohen dhe ndiqen në mënyrë të duhur.

- Ofron këshillim dhe mbështetje praktike për stafin, vullnetarët dhe palët e tjera të interesuara që trajtojnë çështje të mbrojtjes së fëmijëve ose që kanë nevojë për ndihmë në respektimin e politikës.
- Mban të dhëna të qarta dhe të sigurta për të gjitha rastet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, duke respektuar rregulloret për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Oficerja e Mbrojtjes së Fëmijëve siguron që të gjithë anëtarët e bordit, stafi, praktikantët, vullnetarët, ekspertët, partnerët dhe palët e treta të jenë të njohur dhe të ndërgjegjshëm për parimet, rregullat dhe procedurat e kësaj politike.

7. Vlerësimi dhe Zbutja e Rreziqeve

PIF është e angazhuar të projektojë dhe të zbatojë aktivitete që garantojnë një mjedis të sigurt për fëmijët.

Për këtë arsye, vlerësimi i rreziqeve kryhet në përputhje me aktivitetet specifike të çdo projekti. Ne do të sigurohemi, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe zbatimit të praktikave të mira, që stafi dhe personat e tjerë të përfshirë të minimizojnë rreziqet për fëmijët.

Për më tepër, do të ndërmarrim veprime për të zbutur rreziqet, siç vijon:

- Të qëndrojmë vigjilentë ndaj çdo rreziku të mundshëm që mund të paraqitet në aktivitetet ose ndërveprimet ku janë të përfshirë fëmijët.
- Të garantojmë një mjedis të sigurt, si në aktivitetet në terren ashtu edhe në ato online.
- Të ndërmarrim veprime konkrete për të reduktuar ose eliminuar rreziqet, për shembull duke ndjekur rregullat e sigurisë dhe duke përdorur procedurat e duhura.
- Të kërkojmë ndihmë kur nuk jemi të sigurt — të kërkojmë asistencë nga institucione të specializuara kur mungojnë udhëzime të qarta për një situatë të caktuar.

8. Raportimi

Të gjithë anëtarët e stafit dhe çdo person tjetër i angazhuar me PIF kanë mundësinë të raportojnë çdo shqetësim që lidhet me sigurinë ose mirëqenien e një fëmije, duke përdorur formularët e posaçëm të raportimit (referuar në Aneks).

Konfidencialiteti dhe privatësia e personit që bën raportimin ruhen dhe garantohet mbrojtja e tyre.



Çdo raport trajtohet në përputhje me procedurën e përcaktuar dhe administrohet nga Oficeri i Mbrojtjes së Fëmijëve.

9. Llogaridhënia

PIF do të monitorojë rregullisht zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe procedurave të lidhura me të.

Progresi, performanca dhe mësimet e nxjerra do të raportohen çdo vit nga Oficeri i Mbrojtjes së Fëmijëve përpara anëtarëve të Bordit, përmes një raporti formal.

Monitorimi dhe vlerësimi do të përqendrohen në vlerësimin e nivelit të zbatimit efektiv të standardeve të përcaktuara në Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe në funksionimin e mekanizmave mbrojtës, sipas qëllimit të tyre.

Ky proces do të përfshijë realizimin e anketave me stafin e PIF, praktikantët, punonjësit e rinj dhe ekspertët, për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së standardeve, efektivitetin e përgjithshëm dhe identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

10. Konfidencialiteti

PIF siguron regjistrimin, ruajtjen dhe përdorimin e informacionit që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve dhe me raportimet në mënyrë profesionale dhe të sigurt, në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Informacioni do të shpërndahet vetëm me personat e përfshirë, si brenda organizatës ashtu edhe jashtë saj, në rastet kur kjo është e nevojshme.

11. Kontakte referimi jashtë organizatës

Policia

☎ Numri i emergjencës: 129

Linja Kombëtare e Ndhmës për Fëmijët

☎ 116 111

Shërbimi Social Shtetëror

☎ Tel: +355 44 541 842

✉ Email: info@sherbimisocial.gov.al

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror – Tiranë

☎ Tel: +355 4 452 7348



12. Kontakte

Për çdo pyetje, ndihmë, informacion shtesë ose mbështetje lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, ju lutemi referohuni kontaktit të mëposhtëm, sipas situatës:

People in Focus – Oficerja e Mbrojtjes së Fëmijëve

Znj. Armelia Barci

✉ Email: armelia.barci@peopleinfocus.org / peopleinfocusalbania@gmail.com

**Armelia
Barci**

Digitally signed by
Armelia Barci
Date: 2025.04.28
14:40:22 +02'00'



Armelia Barci
Drejtore Ekzekutive
People in Focus

Formulari i Raportimit të Abuzimit ndaj Fëmijëve

1. Të dhëna mbi Raportuesin

Emri i plotë:

Pozicioni:

Organizata:

Natyra e kontaktit me fëmijën:

Të dhënat e kontaktit:

☎ Telefoni:

✉ Email:

2. Të dhëna mbi Fëmijën

Emri i plotë:

Gjinia:

Mosha:

Adresa:

Prindi (t)/Kujdestari (t):

A i është ofruar ndonjë trajtim fëmijës?

☐ Po ☐ Jo

Nëse po, ju lutemi specifikoni në cilin spital dhe në ç'mënyrë është dërguar atje:

3. Detaje mbi Incidentin/Shqetësimin

Si lindi shqetësimi? ☐ Vëzhguar drejtpërdrejt ☐ Dyshuar ☐ Treguar nga dikush tjetër

Nëse është treguar, nga kush dhe cili është raporti i tyre me fëmijën?

Përshkrimi i incidentit (çfarë ndodhi, shkaku nëse dihet) :

(Ju lutemi dalloni qartë faktet e vëzhguara, opinionet dhe informacionet e paverifikuara. Përfshini gjendjen emocionale, dëmtimet e dukshme, etj. nëse ka.)

Data e incidentit të dyshuar:

Ora:

Vendi:

Emri i personit të dyshuar (nëse dihet):

A kanë qenë të përfshirë persona të tjerë?

A janë fëmijë të tjerë në rrezik?

Veprimet e ndërmarra nga ju (nëse ka):

Nënshkrimi:

Data: